

**GJON BORIÇI**

**KREDITË SOVJETIKE AKORDUAR SHQIPËRISË NË  
PERIUDHËN 1945-1960**

**Abstrakt:**

*Marrëdhëniet politike, diplomatike dhe mbi të gjitha ekonomike me Bashkimin Sovjetik ishin guri i themelit të çdo politike të hartuar nga regjimi komunist shqiptar deri në fundin e vitit 1960. Që pas çlirimit të Shqipërisë më 29 nëntor 1944, dhe gjatë gjithë epokës së ndarjes së Europës dhe botës në dy kampe, Shqipëria do t'i qëndronte me fanatizëm deri në fundin e regjimit komunist, modelit stalinist. Marrëdhëniet politiko-ekonomike me Bashkimin Sovjetik dhe marrja e kredive të shumta nga ky vend, ishin jetike për mbajtjen gjallë të regjimit komunist në Shqipëri. Është një fakt i pamohueshëm historik dhe rrjedhimisht ekonomik, se ishin pikërisht ndihmat dhe kreditë që mori shteti shqiptar nga Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik dhe Republika Popullore e Kinës faktorët kryesorë të jetëgjatësisë 45-vjeçare të diktaturës komuniste në Shqipëri. Ideologjia ishte një faktor dytësor në politikën e jashtme të shtetit shqiptar në epokën e Luftës së Ftohtë. Gjithçka bëhej më së shumti për përfitime ekonomike për të mbajtur në këmbë "mësimet" e marksizëm-leninizmit dhe pastërtinë komuniste. Artikulli që po ju paraqesim përfshin një hark kohor prej pesëmbëdhjetë vjetësh 1945-1960 mbi ndihmat e mëdha ekonomike dhe kreditë që iu akorduan Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik. Artikulli është i mbështetur kryesisht në burime primare autentike arkivore shqiptare, ku shumica e të cilave pasqyrohen për herë të parë dhe në literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare që pasqyrojnë të dhëna interesante për këtë periudhë. Nëpërmjet hulumtimit të kujdesshëm të tyre jam përpjekur të jap përgjigje të mbështetura në argumente të cituara për herë të parë se përse Shqipëria u rreshtua totalisht në anën e Bashkimit Sovjetik dhe çfarë përfitoi nga tutela sovjetike lidërshepi komunist duke përjashtuar totalisht çdo mundësi të bashkëpunimit ekonomik dhe politik me Perëndimin. Metodologjia e përdorur në këtë artikull është analitiko-përshkruese lidhur me një nga periudhat më thelbësore të pushtetit komunist në Shqipëri.*

**Fjalë kyçe:**

Shqipëri, Bashkimi Sovjetik, politikë, ekonomi, kredi.

## Përse me Bashkimin Sovjetik?

Shqipëria ishte një nga vendet që u çlirua disa muaj përpara se të përfundonte Lufta II Botërore. Problemet ekonomike, politika dhe të sigurisë me të cilat përballej vendi ishin të mëdha. Pushteti i ri komunist i Enver Hoxhës duhej me domosdo të kishte në vëmendje ndihmat që Shqipëria i kishte tepër të nevojshme të merrte nga Veprimtaria e Administratës së Kombeve të Bashkuara për Ndhimë dhe Rimëkëmbje<sup>1</sup> [më tej: UNRRA\*]. Sipas prof. Hamit Kabës i cili është marrë gjerësisht në studimin e tij lidhur me aktivitetin e UNRRA-s në Shqipëri, vendi i kishte të pamundur të fillonte rimëkëmbjen pa ndihmën e kësaj organizate.<sup>2</sup> UNRRA i ka dhënë një ndihmë ekonomike falas Shqipërisë që arrinte në 31-32 milionë dollarë amerikanë me kursin e atyre viteve.<sup>3</sup> Afërsisht 46% të programit të UNRRA-s e përbënin pajisjet, makineritë dhe lënda e parë, ndërsa pjesa tjetër iu dha qeverisë provizore shqiptare në formën e furnizimeve të destinuara për konsum nga popullsia civile e vendit.<sup>4</sup> Me gjithë ndihmat e mëdha që iu akorduan Shqipërisë në dy vitet e para të pasluftës nga UNRRA, qeveria shqiptare e udhëhequr nga Hoxha do të bënte një sërë hapash të pamenduar mirë në lidhje me aleatët perëndimorë, të cilët nuk do t'i linin asnjë hapësirë tjetër veçse të kalonte tërësisht nën strehën e Jugosllavisë dhe rrjedhimisht të Bashkimit Sovjetik për të mbijetuar ekonomikisht dhe politikisht.

Në vitin 1945, kur ishte e dukshme që vendi ishte në situatë katastrofike financiare, Kryeministri i qeverisë "demokratike" Hoxha, nuk mund të impononte vullnetin e tij në një kohë kur ndihmat e UNRRA-s për Shqipërinë ishin jetike. Trupat anglo-amerikane ishte të stacionuara në Itali e Greqi dhe për momentin dukeshin se ishin më të avancuara për të marrë në dorë pjesën perëndimore të Ballkanit. Kryeministri shqiptar ishte tej mase i interesuar për të pasur në lojë edhe

<sup>1</sup> Hamit Kaba, *UNRRA në Shqipëri, 1944-1947*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Shkenca, 2000, f. 5.

\* *United Nations Relief and Rehabilitation Administration* – UNRRA, u krijua kur Lufta II Botërore ishte në kulmin e saj, e firmosur nga përfaqësuesit e 44 shteteve, në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, më 9 nëntor 1943. Shih për më tepër: *Po aty*, f. 17.

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 11.

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 12.

<sup>4</sup> *Po aty*.

ndihmat e mundshme që mund të merrte nga BS. Për këtë arsye atij i interesonte ç'mendim kishte vendi i madh komunist për UNRRA-n dhe mbi të gjitha a mund ta ndihmonte financiarisht Shqipërinë. Në një artikull të botuar në numrin 1-2 të revistës "Lufta dhe klasa punëtore" nga profesori sovjetik A. Voskresenski, viheshin në dukje shkatërrimet dhe dëmet e mëdha ekonomike që kishte pësuar kontinenti evropian nga Gjermania naziste. Për këtë arsye sipas prof. Voskresenskit, ishte krijuar UNRRA me komision qendror të përbërë nga përfaqësuesit e SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kinës dhe Bashkimit Sovjetik.<sup>5</sup> Sipas këtij artikulli, misioni i vërtetë i UNRRA-s ishte të kontrollonte të gjithë tregtinë botërore.<sup>6</sup> Nëse sipas profesorit sovjetik ky ishte misioni i vërtetë i UNRRA-s, atëherë kjo organizatë nuk do të kishte formë dhe do të synonte të paarritshmen.<sup>7</sup> Problemi më i mprehtë që vinte në dukje ky artikull kishte të bënte me mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve të UNRRA-s [nënkupto: amerikane] si presion politik mbi Europën e çliruar.<sup>8</sup> Kjo do të thoshte se sistemi i ri ekonomik që do të vendosej në Europën e pasluftës, do të ishte ai i kapitalizmit amerikan. Po sipas këtij artikulli, prodhimi në SHBA ishte rritur së tepërmi dhe gjithashtu tregtia nëpërmjet eksportit për njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 1943 ishte rritur me 59% në krahasim me vitin 1942 me një fitim prej 11.5 miliardë dollarë.<sup>9</sup> SHBA, duke qenë se ishin prodhuesi më i madh i mallit industrial dhe bujqësor, ishin njëkohësisht edhe shteti huadhënës më i madh në botë. Pushtimi i tregjeve të jashtme nga ana tyre si dhe kreditimi i vendeve të shkatërruara nga lufta, do të sillte natyrshëm rënien e këtyre të fundit nën dominimin ekonomik dhe politik amerikan. Eksporti sipas këtij studimi i SHBA-së vetëm për vitin 1943 kapte shifrën e 5 miliardë e 221 milionë dollarë.<sup>10</sup>

Sipas përlllogaritjeve që ishin bërë, Bashkimi Sovjetik edhe pse ishte pjesë e UNRRA-s dhe kishte premtuar se do t'i ndihmonte vendet e tjera, përsëri e kishte të pamundur të matej me fuqinë ekonomike të Shteteve të

---

<sup>5</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 490/Këshilli i Ministrave (më tej: KM), Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 107, fl. 134-135.

<sup>6</sup> Po aty, fl. 136.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Po aty, fl. 137.

<sup>9</sup> Po aty, f. 138.

<sup>10</sup> Po aty, fl. 139.

Bashkuara të Amerikës. Vetë gazeta “New York Times” kishte bërë përlllogaritjet përkatëse se sa do të ishte fondi që shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara do të derdhnin në arkën e UNRRA-s. SHBA kryesonin listën me 1 500 000 000 dollarë të ndjekur nga Britania e Madhe me 320 milionë dollarë.<sup>11</sup> Deri në korrik 1944, SHBA kishin derdhur në fondin e UNRRA-s 500 milionë dollarë.<sup>12</sup> Bashkimi Sovjetik, i cili kishte pësuar edhe humbjet më të mëdha njerëzore dhe financiare nga pushtimi nazist dhe nga lufta që ishte bërë në territorin e tij, nuk figuronte në dhjetëshen e parë të shteteve kryesore kontribuese për arkën e UNRRA-s. Madje, qeveria sovjetike kishte deklaruar se dëshironte të merrte vetë ndihma nga UNRRA dhe se shpërndarjen e ndihmave të saj do ta organizonte ajo vetë në territorin sovjetik.<sup>13</sup>

Kaq duhej t'i mjaftonte kryeministrit shqiptar për të kuptuar se kush e kishte mundësinë reale për të ndihmuar vendin e tij për të dalë nga skamja dhe dëshpërimi. Megjithatë, udhëheqësi shqiptar i kishte marrë vendimet e veta. Atij ndihma amerikane i duhej për momentin, por jo të ishte thelbësore, pasi e dinte se Shqipëria nuk do të kishte asnjë lloj mundësie për të shlyer dërgesat amerikane. Ai do ta drejtonte vendin e tij drejt Bashkimit Sovjetik.

Është e pamundur për një shtet të varfër t'i drejtohet një tjetër shteti të varfër për të dalë nga kriza dhe katastrofa ekonomike. Çuditërisht, Enver Hoxha zgjodhi pikërisht këtë rrugë. Kryeministri shqiptar iu drejtua zyrtarisht me një letër më 8 gusht 1945 zëvendës-presidentit të Komisarariatit të Popullit dhe Komisarit të Popullit për Punët e Jashtme të Bashkimit Sovjetik, Vjaçesllav Molotov, lidhur me mundësinë e dërgimit nga ana BS Shqipërisë 250 000 kuintal drithë.<sup>14</sup> Në letër, Kryeministri Hoxha shkruante ndër të tjera se popullin shqiptar e kërcënonte uria dhe qeveria nuk mund të siguronte si pasojë e shkatërrimeve të luftës sasinë e mjaftueshme të drithit për të shmangur këtë katastrofë.<sup>15</sup>

<sup>11</sup> *Po aty*, fl. 140. Përlllogaritja e “New York Times” mbi derdhjen e kapitalit financiar në arkën e UNRRA-s i cili do të përdorej për rindërtim dhe ndihma: "SHBA: \$1.500.000.000; Britania e Madhe: \$320.000.000; Kanadaja: \$90.000.000; Australia: \$40.000.000; India: \$35.000.000; Zelanda e Re: \$8.000.000; Tokat e Afrikës Jugore dhe Egjipti: \$495.000.000".

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> *Po aty*, fl. 142.

<sup>14</sup> *AQSH*, F. 490/KM, V. 1945, D. 5, fl. 2. Kërkesë ministrit të Jashtëm sovjetik Molotov për të dërguar drithë në Shqipëri.

<sup>15</sup> *Po aty*.

Sipas një protokollit konfidencial të hartuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, drithi i kërkuar nga Kryeministri Hoxha u firmos me akord të përbashkët më 22 shtator 1945 me kredinë përkatëse në të njëjtën datë.<sup>16</sup> Kjo kredi, që ishte edhe e para që do të merrte Shqipëria nga Bashkimi Sovjetik, por jo e fundit, ishte në masën \$1 670 000 dollarë dhe shuma e përqindjeve që ka paguar shteti shqiptar deri në likuidimin e saj më datë 30 shtator 1948 ishte \$103 000 dollarë. Po ashtu deri në maj të vitit 1948, Bashkimi Sovjetik i dërgoi Shqipërisë 5.151 ton tërshërë me një vlerë prej \$621 800 dollarë.<sup>17</sup> Kredia e shlyer në shtator 1948 prej Shqipërisë i kushtoi vendit \$1 842 500 dollarë.<sup>18</sup> Po ashtu, Shqipëria detyrohej t'i shlyente BS edhe \$506 000 dollarë për 280 ton bakër të zi dhe 450 ton lëkurë.<sup>19</sup> Të gjitha këto pagesa ishin shlyer me marrëveshje dypalëshe në Tiranë më 4 dhjetor 1948 të firmosur për palën shqiptare nga Vasil Kati si përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe për palën sovjetike nga përfaqësuesi tregtar i BS në Shqipëri, M. Gilaskov.<sup>20</sup>

### Intermexo-ja jugosllave, 1946-1948

Shqipëria e gjysmës së parë të vitit 1945 me gjithë politikat e gabuara ekonomike që ndoqi ku më e rënda ishte shtetëzimi i çdo prone private dhe taksimet e jashtëzakonshme të tregtarëve shqiptarë, përsëri e kishte të pamundur të mbijetonte ekonomikisht. Nëse marrim në shqyrtim marrëdhëniet me shtetet fqinje, me Greqinë situata për një bashkëpunim të mundshëm ekonomik ishte e pashpresë. Me Italinë situata kishte hasur në ngërçe të mëdha financiare. I vetmi vend fqinj që mund të mbështetej Shqipëria dhe që për momentin aplikonte të njëjtin sistem politik ishte Jugosllavia e Titos. Në një informacion të datës 5 maj 1945, Banka e

<sup>16</sup> *Po aty*, F. 490/KM, V. 1945, D. 11, fl. 2. Mbi drithin dhe produktet e tjera kimike të lëvruara nga Bashkimi Sovjetik për Shqipërinë në bazë të kredisë së 22 shtatorit 1945.

<sup>17</sup> *Po aty*.

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> *Po aty*, fl. 3; shih edhe fletët 4 & 5. Mallrat që iu dërguan Shqipërisë nga BS, përfshirë në kredinë e 22 shtatorit 1945, ishin: grurë: 15 021 ton; misër: 5 001 ton; sulfat alumini: 16 ton; sulfat-bakri: 10 ton; sulfat-karbon: 3.8 ton; naftalinë: 55 ton; vakum pompa: copë 2; antacit: 1.513 ton; koks: 2.036 ton; amonit: 105 ton; fitil bikford: 680 000 metra; kapsolla detonatori: 500 000 copë; bakër: 45 ton; duhan: 454 ton; naftë: 100 000 ton; bitum: 10 748 ton; lëkurë dhensh: 207 000 copë; lëkurë dhish: 894 000 copë.

Shtetit Shqiptar njoftonte se Jugosllavia në muajin prill të po këtij viti kishte përfunduar unifikimin monetar të vendit duke zëvendësuar të gjitha bankënotat që qarkullonin në vend [dinarë Nediç, kunas kroate, lira italiane, pengo hungareze, leva bullgare dhe franga shqiptare].<sup>21</sup> E gjithë kjo manovër ishte kryer nga data 20 deri 30 prill 1945 dhe monedha e re jugosllave ishte emetuar prej shtetit dhe jo prej Bankës së Emisionit.<sup>22</sup> Monedha e re jugosllave ishte sipas raportit të Bankës një titull shteti, pa konvertibilitet dhe perspektiva e së cilës në të ardhmen do të ishte njëlloj si ato të biletave të shtetit. Po sipas raportit, kjo monedhë e re konsiderohej e përkohshme për të zgjidhur problemet ekonomike dhe financiare të momentit në Jugosllavi, dhe vetëm pas kësaj etape do të emetohej një monedhë e vërtetë dhe përfundimtare pa hequr këtu ndihmat financiare të jashtme.<sup>23</sup>

Interesant është fakti që na paraqet ky raport i Bankës së Shtetit se vlerën më të lartë të konvertimit dinari i ri jugosllav e kishte me frangën shqiptare [100 franga shqiptare=250 dinarë jugosllavë]<sup>24</sup> çka tregonte se me gjithë problemet ekonomike që kishte Shqipëria në gjysmën e parë të vitit 1945 dhe me gjithë politikat e gabuara ekonomike dhe financiare që po ndiqte qeveria e re komuniste, përsëri monedha shqiptare ishte e qëndrueshme. Me të drejtë Banka e Shtetit Shqiptar shtronte pyetjen: a i korrespondonte ky kurs çmimit real të tregut të frangës shqiptare dhe napolonit ar në Jugosllavi?<sup>25</sup> Përgjigjen e jep vetë raporti me një "Jo" të prerë me justifikimin se sipas lajmeve që kishin nga Beogradi përpara dy javëve, kursi i napolonit ar ishte ndërmjet 58 dhe 80 000 dinarë të vjetër dhe kishte pasur tendencë ngritjeje.<sup>26</sup> Ndërsa me dinarët e rinj 1 napolon ar=3 000 dinarë.<sup>27</sup> Kjo politikë e re që po ndiqte shteti jugosllav kishte sjellë zhvlerësimin e monedhës dhe arit shqiptar në favor të dinarit të ri. Sipas raportit, dinari i ri jugosllav nuk vlente as 40 të qindat e frangës

<sup>21</sup> AQSH, F. 506/BSHSH, V. 1945, D. 42, fl. 1. Raport mbi unifikimin monetar në Jugosllavi dhe mbi rrjedhjet e tij në tregun shqiptar.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Po aty, fl. 2.

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Po aty, fl. 3.

<sup>27</sup> Po aty.

shqiptare dhe rrjedhimisht franga shqiptare gjendej përpara një zhvlerësimi në masën 50% nga vlera e saj reale.<sup>28</sup>

Raporti i paraqitur nga Banka e Shtetit Shqiptar në maj 1945, ishte profesional dhe praktik. Caktimi i një kursi të tillë shkëmbimi kaq të lartë në favor të dinarit i kishte detyruar poseduesit e frangës shqiptare të mos nxitonin ta shkëmbenin këtë monedhë me dinarin e ri, por ta sillnin në Shqipëri dhe të blinin ar.<sup>29</sup> Megjithatë, kishte një problem këtu; diferenca e madhe në kursin e shkëmbimit sillte në Shqipëri gjithë sasinë e kartmonedhës shqiptare të Kosovës duke marrë gjithë arin e tregut shqiptar. Vetëm në pak ditë sipas raportit (28 prill 1945) napoloni ar u rrit nga 610 franga në 660 franga në datën 4 maj duke pasur gjithnjë e më shumë tendencë rritjeje.<sup>30</sup> Rrjedhja jashtë e arit shqiptar ishte dëm kolosal për ekonominë e vendit, sepse ishte i njohur fakti se importimet nga jashtë paguheshin në ar pasi ishte monedhë ndërkombëtare dhe jo me monedhë tjetër.<sup>31</sup>

Po përse kishte ndodhur kjo gjë në tregun shqiptar? Raporti njoftonte se këmbimi i arit me franga ishte si pasojë e pagesave të tatimeve të jashtëzakonshme përmbi fitimet e luftës.<sup>32</sup> Tregtarët shqiptarë duke u gjendur përpara një presioni të madh të brendshëm ku armik kryesor kishin qeverinë, dhe të shtrënguar prej saj siç e kemi parë më lart për të paguar shuma marramendëse në franga shqiptare, kishin filluar të shisnin napolonat e floririt për të paguar marrëzinë ekonomike të Enver Hoxhës që fatkeqësisht nuk do të ishte e para dhe e fundit në këtë fillim pushteti. Akoma me keq, raportonte Banka, ngritja e çmimit të arit do të provokonte edhe rritjen e çmimeve të brendshme për shumë prodhime

<sup>28</sup> *Po aty*. "Megjithë këto, ne po marrim si bazë këtë çmim të fundit: 3 000 dinarë të rinj për një napoleon ar. Sipas kursit të shkëmbimit zyrtar këta 3 000 dinarë duhet të vlejnjë 1 200 franga shqiptare (nga 40 qindarka të frangut shqiptar për 1 dinar të ri), po në realitet vlenin deri më 30 prill 1945 vetëm 610-615 fr. shqiptare, shumë me të cilën blihej 1 napolon ar në tregun shqiptar. Pra, efektivisht 1 dinar i ri jugosllav nuk vlen 40 (dyzet) qindark të frangut shqiptar, si e cakton kursi zyrtar po vetëm 20 (njëzet) qindark. Pra gjendemi përpara një çvleftësimi të frangut në masë prej 50% nga vlefata e tij reale. Çështja ka për ne një rëndësi praktike të madhe, si ka për t'u parë më poshtë".

<sup>29</sup> *Po aty*, fl. 3-4. "Llogaria është e thjeshtë: Me 610-615 fr.shq. ata do të merrnin vetëm 1525-1550 dinarë të rinj (sipas kursit zyrtar) ata vijnë në Shqipëri dhe blejnë një napoleon ari që vlen rreth 3 000 dinarë të rinj. Diferenca, pra fitimi, është tepër i madh".

<sup>30</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>31</sup> *Po aty*.

<sup>32</sup> *Po aty*.

dhe rrjedhimisht do të shtrenjtohej jetesa dhe pasojat mund të ishin të paparashikueshme (shoqërore, financiare dhe politike).<sup>33</sup>

Të shqetësuar nga informatat që kishte dërguar nga Beogradi Kiço Ngjela, më 21 maj 1946, Byroja Politike e KQ të PKSH organizoi një mbledhje të veçantë ku u diskutuan pikat e marrëveshjeve të mundshme ekonomike me fqinjën verilindor.<sup>34</sup> Në diskutimin e tij Kiço Ngjela kishte deklaruar se drafti i marrëveshjes ekonomike ishte formal dhe kishte shfaqur dyshime veçanërisht për nenin 4, për dhënien 2 000 000 000 dinarë kredi pa kamatë që ishte e paprecizuar dhe në këtë mënyrë nuk mund të firmosej.<sup>35</sup> Një tjetër element që të bënte të dyshojë në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ishte edhe diskutimi lidhur me çmimet unike, të cilat Kidriç [Boris Kidrič, kryetar i Këshillit Ekonomik Jugosllav] i kishte thënë Enver Hoxhës se "nuk do të kishte çmime unike, por vetëm strukturë unike".<sup>36</sup> Kiço Ngjela i pranishëm në diskutimet që ishin zhvilluar në Beograd, i kishte deklaruar Kidriçit se meqenëse Shqipëria do t'i blinte mallrat në Jugosllavi çmimet normalisht nuk do të ishin njëjloj, pasi do të paguheshin më shtrenjtë.<sup>37</sup> Ngjela kishte kundërshtuar që nga kredia 2 miliardë dinarë, Shqipëria të mbante rezervë 300 milionë pasi çmimet ishin parashikuar të ishin shumë të larta dhe për këtë arsye kishte rekomanduar të mbaheshin rezervë vetëm 100 milionë.<sup>38</sup> Lidhur me vërejtjet e paraqitura nga Kiço Ngjela, edhe vetë Enver Hoxha ishte dakord ashtu si e gjithë pjesa tjetër e Byrosë Politike që të hiqej neni 4 i akordit tregtar.<sup>39</sup>

Edhe pse po shfaqnin probleme të mprehta që në fillimet e tyre, marrëdhëniet me Jugosllavinë do të ishin të veçanta për hir të interesit të

<sup>33</sup> *Po aty*.

<sup>34</sup> *AQSH*, F. 14/ Organet Udhëheqëse (më tej: OU), V. 1946, D. 8, fl. 10. Mbledhje e Byrosë Politike e KQ të PKSH-së lidhur me marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë.

<sup>35</sup> *Po aty*.

<sup>36</sup> *Po aty*.

<sup>37</sup> *Po aty*.

<sup>38</sup> *Po aty*, fl. 11. Pjesë nga rekomandimi i Kiço Ngjelës në mbledhjen e Byrosë Politike: "Kiço tha se 300 milion është shumë si rezervë pse edhe çmimet janë parashikuar shumë të larta prandaj të liresh vetëm 100 milion. Ata thanë se nuk mund të shtohesh asgjë u shtuan vetëm 20 traktorë e 10 makina shirëse tjetër gjë tani s'japim gjë që do ta studiojmë nëse mund të shtojmë diçka në manifakturë. Realizimi i materialit gjatë këtij viti është shumë i zorshëm. Nga 480.000.000 importimi është zor të realizohen të gjitha pse porositë janë bërë tani dhe është zor të gjenden. Prandaj duhet të rishqyrtojmë planin dhe të lëmë rezervë".

<sup>39</sup> *Po aty*, fl. 12.

pushtetit personal të Enver Hoxhës. Më datë 6 gusht 1946 me ligjin nr. 272, Kuvendi i Shqipërisë dekretoi ratifikimin e Traktatit të Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.<sup>40</sup> Ky traktat që ishte firmosur së pari në Tiranë më 9 korrik 1946 nga Kryeministri dhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Enver Hoxha dhe nga ministri i Jashtëm jugosllav Stanoje Simić (Simić)<sup>41</sup>, e vendoste totalisht Shqipërinë nën tutelën e Jugosllavisë, një arritje kjo për shtetin jugosllav.

Më 18-20 dhjetor 1946 për të "sqaruar" partinë dhe popullin mbi konventën ekonomike të nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946, mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, u mbledh Plenumi i jashtëzakonshëm i KQ të PKSH-së ku u diskutuan pikat e mëposhtme të kësaj konvente:

1. Koordinimi i planeve ekonomike ndërmjet dy vendeve;
2. Heqja e kufirit dhe e taksave doganore;
3. Parifikimi i monedhës shqiptare me atë jugosllave.<sup>42</sup>

Sipas rezolucionit që u paraqit në plenum, nënshkrimi i kësaj konvente bënte që Shqipëria të hynte në një fazë të re historike. Arsyeja e nënshkrimit të konventës ekonomike në justifikimin e lidërshiptit të PKSH-së kishte të bënte me ngushtimin e hapësirës ndërmjet pushtetit politik në Shqipëri dhe gjendjes ekonomike të vendit.<sup>43</sup>

Qeveria e Enver Hoxhës pasi kishte "hedhur në erë" çdo mundësi bashkëpunimi me aleatët perëndimorë, ishte rreshtuar totalisht në krahun e Kampit Socialist të drejtuar nga Bashkimi Sovjetik. Ky i fundit në sferën e tij të ndikimit kishte fituar një shtet si Shqipëria për të cilin i kishte lënë dorë krejtësisht të lirë Jugosllavisë për të gllabëruar Shqipërinë, por jo Bullgarinë që konsiderohej në kundërshtim me

---

<sup>40</sup> AQSH, F. 490/KM, V. 1946, D. 119, fl. 1. Ligj mbi ratifikimin e Traktatit të Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke ndërmjet RPSH-së dhe RSFJ-së.

<sup>41</sup> *Po aty*, fl. 3.

<sup>42</sup> *Po aty*, F. 14/Strukturë (më tej: Str), V. 1946, D. 171/1, fl. 247. Njoftim mbi rezolucionin e Plenumit të jashtëzakonshëm të KQ, më datë 22 dhjetor 1946; shih edhe *po aty*, F. 14/OU, V. 1946, D. 4, fl. 42-43. Procesverbal, dorëshkrime në dy variante dhe rezolucioni i mbledhjes së jashtëzakonshme të Plenumit të KQ të PKSH, më datë 18-20 dhjetor 1946, mbi vënien në dijeni të kuadrove dhe qarqeve mbi konventën ekonomike të nënshkruar në Beograd, më 27 nëntor 1946, ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

<sup>43</sup> *Po aty*.

preferencat sovjetike.<sup>44</sup> Fakt për këtë është takimi Stalin-Tito i 27 majit 1946, në të cilin lideri sovjetik këshilloi që Shqipëria të ishte pjesë e Jugosllavisë.<sup>45</sup> Megjithatë, në vitin 1948, Jugosllavia do të përjetonte "çarjen" e madhe me Bashkimin Sovjetik si pasojë e refuzimit nga ana e këtij të fundit të bisedimeve tregtare, gjë që do të bënte të mundur ndjekjen e një politike të pavarur nga ana e saj,<sup>46</sup> por edhe do të çlironte Shqipërinë nga "tutela" jugosllave për t'iu bashkëngjitur totalisht strukturave politiko-ekonomike të ngritura nga Moska. Me prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, shteti shqiptar kaloi në sovjetizim të plotë në të gjitha aspektet e jetës.<sup>47</sup>

### **Bilancet e kredive të marra nga Shqipëria prej Bashkimit Sovjetik 1947-1956**

Një nga veprimet e para që bëri qeveria shqiptare për t'i treguar BS se ishte vend besnik ndaj strukturës socialiste në ekonomi të ngritur nga Moska ishte edhe kërkesa për t'u pranuar në Këshillin Ekonomik të Ndhmës Reciproke [më tej: KNER] më 8 shkurt 1949.<sup>48</sup> Për t'i treguar BS-së se Shqipëria ishte vend ku mund të investohej, Kryeministri Hoxha i dërgoi një letër Stalinit më 16 nëntor 1949 lidhur me mundësinë e zhvillimit më të madh të ekonomisë shqiptare nga dërgimi i specialistëve sovjetikë për të përcaktuar pasuritë nëntokësore të Shqipërisë.<sup>49</sup> Për zhvillimin e ekonomisë shqiptare duheshin patjetër kredi. BS kishte pranuar të kreditonte shtetin shqiptar për të ngritur industrinë shqiptare. Kreditë nga ana Bashkimit Sovjetik, dërguar Shqipërisë siç e pamë edhe më lart, kishin filluar që në muajin shtator 1945 për të vijuar në vitin 1947 deri në vitin 1959. Protokollet e nënshkruara ndërmjet dy vendeve duke filluar nga viti 1947 nuk ishin avantazhuese për ekonominë shqiptare. Të gjitha kreditë që do të merrte Shqipëria jo vetëm nga BS,

<sup>44</sup> Vladimir Unkovski-Korica, *The Economic Struggle for Power in Tito's Yugoslavia; from World War II to Non-Alignment*, London & New York: I.B. Tauris, 2016, f. 32.

<sup>45</sup> Hamit Kaba & Ethem Çeku, *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse 1946-1962*, Tiranë: Flamuri, 2017, f. 24.

<sup>46</sup> V. Unkovski-Korica, *The Economic Struggle for Power in Tito's Yugoslavia...*, f. 58-59.

<sup>47</sup> Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, bot. II, Tiranë: GEER, 2022, f. 26.

<sup>48</sup> H. Kaba & E. Çeku, *Shqipëria dhe Kosova...*, f. 86-87.

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 114.

por edhe nga vendet e tjera të Kampit Socialist do të kishin një interes vjetor për kohën dhe për një vend të varfër si Shqipëria prej 2%<sup>50</sup>, që do të thoshte se Shqipëria duhej thujse të paguante dyfish shumën e marrë. Siç do ta shikojmë, Shqipëria ka paguar totalisht të gjitha kreditë e marra nga BS edhe pse marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy vendeve u ndërpre në më 3 dhjetor 1961.<sup>51</sup>

Nga hulumtimi i kujdesshëm i dokumenteve arkivore, më rezultoi se nga Bashkimi Sovjetik për periudhën 1947-1956, Shqipëria ka marrë kredi 557 310 000 rubla.<sup>52</sup> Duhet theksuar se kursi i këmbimit për ato vite deri në mesin e viteve '60 ndërmjet rublës dhe dollarit amerikan ishte 1 dollar\$=1 rubël sovjetike.<sup>53</sup>

Me këtë vend, kreditë ishin ndarë në tri pjesë:

- a. Kreditë e marra prej vitit 1947, ku përfshiheshin të gjitha kreditë industriale dhe të mallrave që kishin të njëjtat kushte shlyerjeje;
- b. Kredia prej 48 milionë rublash për bujqësinë, fabrikën e kadifes me kushte të ndryshme shlyerjeje nga kredia e pikës a.
- c. Kreditë 84.1 milionë rubla që përfaqësonin kreditë speciale (për ushtrinë).<sup>54</sup>

Në kreditë speciale që kishte marrë Shqipëria nga Bashkimi Sovjetik, ishte përfshirë edhe vlera prej 2.8 milionë rubla që përfaqësonte shtypjen e kartëmonedhës në vitin 1949.<sup>55</sup> Përdorimi i kredisë prej 48 milionë rublash ishte parashikuar që të bëhej në vitet 1954-1957 me termat e mëposhtëm:

- a. 30 milionë rubla për bujqësinë, të përdorshme në vitet 1954-1956.
- b. 8 milionë rubla për fabrikën e kadifes, të përdorshme në vitet 1954-1956.

<sup>50</sup> *AQSH*, F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar [më tej: BSHSH], V. 1955, D. 19, fl. 3. "Dërgim bilanci i pagesave për marrëveshje tregtare të Republikës Popullore të Shqipërisë me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike dhe Demokracitë Popullore", Tiranë, 17 maj 1955.

<sup>51</sup> Gj. Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze...*, bot. II, f. 76.

<sup>52</sup> *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1956, D. 20, fl. 22. Evidencë e kredive të akorduara nga Bashkimi Sovjetik, Republika Popullore e Kinës dhe Kampi Socialist.

<sup>53</sup> Frank Dikötter, *Mao's great famine; the history of China's most devastating catastrophe, 1958-1962*, New York: Walker & Co., 2010, f. 74. Kursi i këmbimit rubël/yuan ka qenë 1 rubël=2.22 yuan, dhe rubël/dollar 1 me 1 për vitet '50-'60.

<sup>54</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1955, D. 236, fl. 2. Bilanci i pagesave për marrëveshje tregtare të Republikës Popullore të Shqipërisë me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike.

<sup>55</sup> *Po aty*.

- c. 10 milionë rubla për pagimin e pajisjeve të ndërmarrjeve komplete të akorduara më përpara në bazë të marrëveshjeve të viteve 1949 dhe 1951, të përdorshme në vitet 1954-1957.<sup>56</sup>

Sipas të dhënave që dispononte Ministria e Financave e Shqipërisë, kredia prej 48 milionë rublash ishte përdorur gjatë vitit 1954 në masën 2 milionë e 150 mijë rubla.<sup>57</sup> Për vitin 1957, nga kjo kredi nuk parashikohej të përdorej asgjë pasi e gjitha do të përdorej në vitet 1955-1956 për objektet në ndërtim.<sup>58</sup> Për sa i përkonte kredisë së veçantë (speciale) mbetja e saj deri më datë 31 dhjetor 1954 rezultonte e papërdorshme për vitin 1955.<sup>59</sup> Kreditë që kishte marrë Shqipëria nga Bashkimit Sovjetik ishin të mëdha dhe sipas marrëveshjeve të nënshkuara, deri në vitin 1972 i detyrohej 499 065 000 rubla.<sup>60</sup>

### **Kërkesa për kredi të reja nga BS në gjysmën e dytë të viteve '50**

Pa mbaruar vitet '50, Shqipëria iu drejtua kësaj radhe të gjitha vendeve të demokracive popullore për të marrë kredi nga ato, pasi situata ekonomike që po kalonte vendi dhe mungesat në investime po e rëndonin akoma më shumë mirëqenien e banorëve. Padyshim, vendit të parë që qeveria e RPSH iu drejtua, ishte Bashkimi Sovjetik. Më 7 tetor 1958, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë [më tej: PPSH] Enver Hoxha, i dërgoi një letër të gjatë Sekretarit të Parë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Nikita Hrushov.<sup>61</sup> Në letër, Hoxha përpiqej t'i shpjegonte Hrushovit arsyet se përse Shqipëria kishte nevojë për kredi nga ana e Bashkimit Sovjetik në masën 400 milionë rubla për t'u përdorur gjatë periudhës së pesëvjeçarit të tretë 1961-1965.<sup>62</sup> Enver Hoxha që në fillim të letrës i shkroi Hrushovit se sa të larta ishin zhvillimet në prodhimet industriale në vend duke i krahasuar ato me

<sup>56</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>57</sup> *Po aty*.

<sup>58</sup> *Po aty*.

<sup>59</sup> *Po aty*.

<sup>60</sup> *Po aty*, fl. 6.

<sup>61</sup> *AQSH*, F. 490/KM, V. 1958, D. 1125, fl. 1. Letër e Komitetit Qendror të PPSH-së për kredi për 5-vjeçarin III 1961-1965.

<sup>62</sup> *Po aty*, fl. 8.

prodhimet e para luftës.<sup>63</sup> Për sukseset e mëdha që kishte korrur populli shqiptar në ndërtimin e socializmit ishte meritë e punës vetëmohuese të tij dhe, mbi të gjitha, e ndihmës bujare nga ana e Bashkimit Sovjetik.<sup>64</sup> Megjithatë, edhe pse sukseset sipas Hoxhës ishin të mëdha, ato përsëri ishin të pamjaftueshme. Sipas tij, pesëvjeçari i parë dhe i dytë ishin thjesht hapi i parë drejt procesit të industrializimit.<sup>65</sup> Bujqësia dhe industria shqiptare kishin ende ritme të ulëta zhvillimi dhe ishin ende larg nivelit të jetesës së vendeve fqinje: Greqisë, Jugosllavisë dhe Italisë.<sup>66</sup>

Enver Hoxha synonte që me ndihmën në kredi nga ana e Bashkimit Sovjetik ta kthente vendin nga agraro-industrial në industrialo-agrar. E gjithë kjo, sipas tij duhej të realizohej në pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.<sup>67</sup> Sipas Hoxhës, në planin e tretë pesëvjeçar parashikohej të rritej prodhimi industrial në masën 72% me një ritëm mesatar vjetor prej 11,9%.<sup>68</sup> Po ashtu, volumi i ndërtimeve do të ishte rreth 83% më i madh.<sup>69</sup> Zhvillimi i sektorit të minierave kishte rëndësi të veçantë për ekonominë shqiptare sipas Hoxhës pasi ato dhe veçanërisht industria e naftës kishin relativisht perspektivë të madhe zhvillimi.<sup>70</sup> Industria e naftës vetëm për pajisjet që do të importoheshin kërkonte mbi 400 milionë rubla.<sup>71</sup> Me këtë investim parashikohej që në vitin 1965 rezervat e Shqipërisë me naftë do të kapnin shifrën 2.5 milionë ton.<sup>72</sup>

Zhvillimi i industrisë së rëndë ishte prioritar në politikat ekonomike të qeverisë shqiptare. Nga hulumtimi i kujdesshëm i këtij dokumenti, kërkesat për investime në bujqësi dhe industrinë e lehtë nuk janë aq të detajuara si ato të industrisë së rëndë. Uzina e plehut azotik dhe kombinati kimiko-metalurgjik ishin padyshim dy veprat madhore që do t'i

<sup>63</sup> *Po aty*. Pjesë nga letra e Enver Hoxhës dërguar Nikita Hrushovit: "Prodhimi industrial për vitin 1958 është rreth 17.6 herë më i madh dhe prodhimi bujqësor rreth 120% më i madh se para luftës. Prodhimi industrial tash përbën rreth 47% dhe prodhimi bujqësor rreth 53% të volumit të përgjithshëm të prodhimit industrial e bujqësor".

<sup>64</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>65</sup> *Po aty*.

<sup>66</sup> *Po aty*.

<sup>67</sup> *Po aty*.

<sup>68</sup> *Po aty*, fl. 3.

<sup>69</sup> *Po aty*.

<sup>70</sup> *Po aty*. "...prandaj kemi parashikuar që në pesëvjeçarin e tretë prodhimi i industrisë së naftës të rritet 100%, i industrisë së kromit 21%, i industrisë së bakrit 75%, i industrisë së qymyrgurit 53%, nxjerrja e mineralit hekur-nikelit 150%".

<sup>71</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>72</sup> *Po aty*.

kushtonin Shqipërisë një pjesë të mirë të kredisë. Mijëra ton helme e kimikate do të prodhonin këto fabrika, të cilat do t'i shkaktonin dëme të mëdha jo vetëm ekonomisë shqiptare, por edhe mjedisit. Kombinati kimiko-metalurgjik do të kishte në përbërje të tij disa uzina si ajo e plehut fosfatik me kapacitet 100 mijë ton superfosfat në vit, uzina e prodhimit të acidit sulfurik me kapacitet 70 mijë ton në vit, uzina e shkrirjes së bakrit me kapacitet 2 500 ton bakër blister në vit dhe me perspektivë zgjerimi në 500 ton në vit, uzina e ferro-kromit me kapacitet 37 mijë ton ferrokrom në vit dhe uzina e prodhimit të sulfatit të bakrit me kapacitet 4 000 ton në vit.<sup>73</sup>

Po për pesëvjeçarin e tretë, Shqipëria me anë të kësaj letre sqaruese të Enver Hoxhës parashikonte të ngrinte një industri të tërë për përdorimin e gazit të naftës me fabrika që do të ndërtoheshin në Qytetin Stalin (sot Kuçovë), Vlorë, Durrës, Elbasan dhe Tiranë.<sup>74</sup> Gjithashtu, me paratë sovjetike parashikoheshin të ndërtohej një TEC (pa specifikuar se ku) me kapacitet 48 mijë kw dhe me perspektivë zgjerimi gjer në 72 mijë kw në bazë të gazit të naftës.<sup>75</sup> Për industrinë e komunikacioneve (rrugët dhe hekurudhat) investimet parashikoheshin vetëm 11%<sup>76</sup>, kur në fakt do të duhej të zinin pas bujqësisë investimet më të mëdha për të shndërruar Shqipërinë në një atraksion turistik. Enver Hoxha shpjegonte në këtë letër se ishte i ndërgjegjshëm për shpenzimet e mëdha që kërkonte pesëvjeçari i tretë dhe se rritja e eksporteve do të bënte të mundur që Shqipëria të ecte me këmbët e veta ekonomikisht vetëm nga fundi i pesëvjeçarit të katërt.<sup>77</sup> Për Enver Hoxhën, realizimi i investimeve të pesëvjeçarit të tretë do të çelte perspektivën për ngritjen e nivelit të jetesës së masave punonjëse në një masë më të madhe në pesëvjeçarin e katërt.<sup>78</sup>

A mund të rritej ekonomia dhe mirëqenia e shqiptarëve në pesëvjeçarin e katërt kur vetë Enver Hoxha pranoi në këtë letër se bilanci i pagesave që duhej të kryente vendi për të përmbushur pesëvjeçarin e tretë ishte 700 milionë rubla?!<sup>79</sup> Për ta ulur Shqipërinë me këmbë në tokë, Bashkimi Sovjetik kishte dërguar në vitin 1957 një grup ekspertësh dhe

<sup>73</sup> *Po aty*, fl. 6.

<sup>74</sup> *Po aty*.

<sup>75</sup> *Po aty*.

<sup>76</sup> *Po aty*.

<sup>77</sup> *Po aty*, fl. 7.

<sup>78</sup> *Po aty*.

<sup>79</sup> *Po aty*, fl. 8.

specialistësh për hartimin e planeve 5-vjeçare duke filluar nga viti 1961 e duke përfunduar deri në vitin 1975 për të studiuar mundësinë e zhvillimit perspektiv të Shqipërisë.<sup>80</sup> Sipas ekspertëve sovjetikë, me të cilët bie dakord edhe vetë Hoxha, Shqipëria do të mund të ecte me këmbët e veta vetëm nga viti 1970 dhe deri atëherë e kishte të domosdoshme të merrte kredi nga vendet miq.<sup>81</sup> Për këtë arsye, Enver Hoxha në emër të KQ të PPSH-së i kërkoi Komitetit Qendror të PKBS një kredi prej 400 milionë rublash për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.<sup>82</sup> Ndërsa për industrinë e naftës, Enver Hoxha i kërkoi në po të njëjtën letër Hrushovit një kredi prej 35 milionë rublash për të blerë pajisje për këtë industri vetëm për vitet 1959 dhe 1960.<sup>83</sup> Në fund të letrës, Enver Hoxha e vuri në dijeni Hrushovin se Shqipëria do t'u drejtohej për kredi edhe vendeve të tjera të demokracive popullore për të realizuar me çdo kusht me sukses sipas tij pesëvjeçarin e tretë.<sup>84</sup>

Këto kredi të reja do ta rëndonin edhe më shumë ekonominë e brishtë shqiptare. Deri më 31 dhjetor 1958, sipas dokumenteve që kam hulumtuar, Republika Popullore e Shqipërisë ka marrë kredi nga vendet e Kampit Socialist 1 425 400 000 rubla.<sup>85</sup> Nga kreditë e akorduara, sipas këtij materiali sekret, bie në sy fakti se Bashkimi Sovjetik i kishte falur Shqipërisë 426 751 000 rubla, Republika Popullore e Kinës 30 000 000 rubla dhe Republika Demokratike Gjermane 61 500 000 rubla.<sup>86</sup>

Bashkimi Sovjetik mbetej edhe kreditori më i madh i Shqipërisë. Që nga viti 1947 e deri në vitin 1958 shuma totale e kredive të akorduara prej tij në një vend me 1.3 milionë banorë ishte 742 100 000 rubla.<sup>87</sup>

---

<sup>80</sup> *Po aty.*

<sup>81</sup> *Po aty.*

<sup>82</sup> *Po aty.*

<sup>83</sup> *Po aty*, fl. 9.

<sup>84</sup> *Po aty.*

<sup>85</sup> *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1958, D. 32, fl. 1. "Kredi të akorduara nga Kina dhe kampi socialist: Bashkimi Sovjetik 742.100.000 rubla; Republika Popullore e Kinës 80.000.000 rubla; Republika Popullore e Rumanisë 95.200.000 rubla; Republika Popullore e Bullgarisë 43.800.000 rubla; Republika Popullore e Hungarisë 80.000.000 rubla; Republika Demokratike Gjermane 101.500.000 rubla; Republika Popullore e Polonisë 35.000.000 rubla; Republika Socialiste Çekoslovake 197.800.000 rubla".

<sup>86</sup> *Po aty.*

<sup>87</sup> *Po aty.* "Kredi të akorduara nga Bashkimi Sovjetik 1947-1957: 25 korrik 1947, 45.000.000 rubla; 3 shtator 1947, 26.000.000 rubla; 9 prill 1949, 104.000.000 rubla; 31 janar 1950, 19.000.000 rubla; 9 shkurt 1951, 69.000.000 rubla; 9 shkurt 1951, 18.000.000 rubla; 2 korrik 1954, 48.000.000 rubla; 18 korrik 1955, 45.000.000 rubla;

Keqpërdorimi dhe investimi i gabuar i këtyre kredive nga udhëheqja komuniste shqiptare nuk bënin të mundur ngritjen e nivelit të jetesës së popullit shqiptar.

### **Problemet ekonomike të Shqipërisë përpara vizitës së Hrushovit në Tiranë dhe falja e një pjesë të kredive pas vizitës së liderit sovjetik**

Më 6 shkurt 1959, në një njoftim të Bankës së Shtetit Shqiptar, njoftohej Ministria e Financave se përdorimi i kredisë që i ishte akorduar Shqipërisë nga ana e BS-së në vitin 1955 në shumën 35 milionë rubla, do të fillonte të lëvrohej këtë vit.<sup>88</sup> Sipas njoftimit të Gosbank-ës [Banka Shtetërore Qendrore e Bashkimit Sovjetik], deri më 15 nëntor 1959, kjo kredi duhej të lëvrohej çdo muaj në masën 7 500 000 rubla dhe nga 1 250 000 rubla shtesë të llogarisë në klering.<sup>89</sup> Kjo kredi ashtu si dhe të gjitha kreditë e tjera që kishte marrë shteti shqiptar (me përjashtim të RPK-së), e kishte normën e interesit 2%. Shlyerja e shumave të kreditit do të bëhej gjatë dhjetë vjetëve me këste vjetore të barabarta duke filluar nga 1.01.1966.<sup>90</sup>

Një tjetër problem që parashtronte Banka e Shtetit Shqiptar, ishte edhe presioni në të cilin ndodhej pasi jo vetëm Banka e Bashkimit Sovjetik, por edhe bankat e vendeve të demokracive popullore kishin dërguar letra lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të përfunduara.<sup>91</sup> Kredia prej 35 milionë rubla që kishte marrë shteti shqiptar, do të investohej e tëra në industrinë e naftës,<sup>92</sup> tek e cila Enver Hoxha kishte përqendruar në këtë kohë edhe kreditë më të mëdha të akorduara nga BS. Presioni ekonomik në të cilin ndodhej RPSH në këtë moment ishte i

---

26 qershor 1956, 55 milion rubla; 17 prill 1957, 31.000.000 rubla; 22 nëntor 1957, 160.000.000 rubla. Kredi speciale (për ushtrinë): 21 korrik 1954, 84.100.000 rubla; 23 mars 1956, 38.000.000 rubla".

<sup>88</sup> *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1959, D. 36, fl. 1. Çelje llogarish nga Gosbanka.

<sup>89</sup> *Po aty*.

<sup>90</sup> *Po aty*. "Përqindja e interesit bankar do të paguhej gjatë viteve 1966-1975 me këste vjetore të barabarta, në tremujorin e parë të çdo viti, kurse përqindja e llogaritur nga viti 1966 do të shlyhet në tremujorin e parë të çdo viti të vitit pasardhës për të cilin janë llogaritur, ku përqindja e llogaritur për vitin 1975 do të paguhet njëkohësisht me detyrimin kryesor".

<sup>91</sup> *Po aty*, fl. 6. Njoftim i Bankës së Shtetit Shqiptar, më 10 prill 1959.

<sup>92</sup> *Po aty*, fl. 12.

madh. Më 3 mars 1959, nga departamenti i marrëdhënieve me jashtë i Bankës Shtetërore të Bashkimit Sovjetik, erdhi kërkesa për të filluar shlyerjen e kredisë sipas marrëveshjes së 22 nëntorit 1957 për shumat e përdorura në vitin 1958.<sup>93</sup> Për këto shuma sipas marrëveshjes, duke filluar nga viti 1960 e deri në vitin 1969, Shqipëria detyrohej t'i paguante Bashkimit Sovjetik 10 207 480,23 rubla.<sup>94</sup>

Dy ditë më vonë, më 5 mars 1959, nga Banka Shtetërore e Bashkimit Sovjetik erdhi një tjetër letër ku i kërkohej me mirësjellje Shqipërisë të fillonte të shlyente kreditë sipas marrëveshjeve të 21 korrikut 1954, 18 korrik 1955, 26 qershor 1956 dhe protokollit të 23 marsit 1956.<sup>95</sup> Sipas këtyre marrëveshjeve duke filluar nga viti 1960 e deri në vitin 1969, Shqipëria detyrohej t'i paguante Bashkimit Sovjetik 18 967 110,48 rubla.<sup>96</sup> Po ashtu, për kredinë e vitit 1958, ishte rënë dakord që shlyerja të fillonte nga viti 1975 deri në vitin 1984 në shumën 63 074 085,15 rubla.<sup>97</sup> Këtyre kërkesave të ardhura nga Banka Shtetërore e Bashkimit Sovjetik, Shqipëria iu përgjigj në datën 23 mars 1959. Shqipëria premtonte se do të fillonte menjëherë derdhjen e shumave përkatëse në llogaritë e hapura për këtë qëllim që të fillonte likuidimi i tyre sipas marrëveshjeve.<sup>98</sup>

Presioni ekonomik që po fillonte të ndiente Shqipëria ishte i dukshëm. Ishte e pamundur të merrte aq shumë kredi dhe asnjëra prej tyre të kishte efikasitet shlyerjeje. Për të gjithë dhjetëvjeçarin e viteve '50 të shek. XX, në asnjë raport të OKB-së nuk pasqyrohet që vendi të kishte shenja rritjeje ekonomike jo e jo, por as prodhim neto në industri (NMP-Net Material Product).<sup>99</sup>

<sup>93</sup> AQSH, F. 506/BSHSH, V. 1959, D. 43, fl. 1. "Amortissement des crédits accordés par l'Union Soviétique à la République Populaire d'Albanie".

<sup>94</sup> Po aty, fl. 4.

<sup>95</sup> Po aty, fl. 7. "Au sujet de l'amortissement des crédits alloués par l'Union Soviétique des RSS à la République Populaire d'Albanie".

<sup>96</sup> Po aty, fl. 8. Shuma e lartpërmendur do të shlyhej çdo vit në masën 1 896 711,48 rubla.

<sup>97</sup> Po aty, fl. 9. Shuma e lartpërmendur do të shlyhej çdo vit në masën 6 307 408,15 rubla.

<sup>98</sup> Po aty, fl. 10, 11. Nga 13 milionë rubla që ishte parashikuar kredia sipas protokollit të 26 majit 1958, shuma ishte rritur në 38 milionë rubla.

<sup>99</sup> Ian Jeffries, *Socialist economies and the transition to the Market; a guide*, London & New York: Routledge, 1993, f. 229. Llogaritja e NMP-së të Shqipërisë sipas këtij raporti të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara fillon në dhjetëvjeçarin 1961-1970 me 7,4%, që janë edhe zeniti i marrëdhënieve shqiptaro-kineze dhe akordimi i kredive të mëdha nga ana e RPK-së.

Gjatë gjithë bisedimeve kur Hrushovi vizitoi Shqipërinë, sipas Hoxhës e kishte vënë theksin tek ana komerciale dhe jo se sa do të prodhonte vendi.<sup>100</sup> Gjithashtu, edhe për industrinë e rëndë ai kishte thënë se duhej parë me kujdes veçanërisht puna e naftës e cila ishte e rëndë pasi përmbante squfur.<sup>101</sup> Theksin kryesor, lideri sovjetik e kishte vënë tek industria e lehtë dhe te kulturat e agrumeve.<sup>102</sup> Sipas tij, nëse Shqipëria do të mbillte me shumicë agrume, të gjitha këto do t'ia blinte Bashkimi Sovjetik.<sup>103</sup> Në të gjithë raportin që paraqiti përpara Byrosë Politike më datë 6 qershor 1959, Enver Hoxha u mundua t'i paraqiste sa më miqësore bisedimet që kishte kryer me Nikita Hrushovin. Nga hulumtimi i kujdesshëm i kësaj dosjeje, kam arritur të gjej edhe një material tepër sekret, ku pasqyrohen realisht vërejtjet e kryeministrit sovjetik në lidhje me ekonominë dhe industrinë shqiptare.<sup>104</sup>

Aty shihet qartë se Hrushovi nuk bëri asnjë aludim siç ka shkruar Hoxha në librin e tij "Hrushovianët" se, ai [Hrushovi] duke kaluar nga Butrinti nëpër Vlorë i kishte thënë ministrit sovjetik të Mbrojtjes Rodion Malinovksi e që Hoxha e kishte dëgjuar:

"Mund të ndërtohet një bazë ideale për nëndetëset tona. Të gërmohen e të hidhen në det këto vjetërsira, ta shpojme këtë mal dhe dalim matanë. Do të kemi në dorë bazën më ideale e më të sigurt në Mesdhe. Që këtej mund të paralizojmë e të sulmojmë gjithçka".<sup>105</sup>

Edhe kjo frazë e Hrushovit e shkruar nga Enver Hoxha nuk është e vërtetë. Hoxha flet në Byronë Politike të kësaj date lidhur me atë se çfarë kishte thënë Hrushovi për pozitën strategjike të Shqipërisë ku del qartë se ai nuk kishte bërë asnjë aludim për të paralizuar apo për të sulmuar ndokënd.<sup>106</sup> Enver Hoxha e kishte shprehur gjithmonë gatishmërinë e tij

<sup>100</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1959, D. 18, fl. 1. Protokoll i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 6 qershor 1959, fl. 3.

<sup>101</sup> *Po aty*.

<sup>102</sup> *Po aty*, fl. 6.

<sup>103</sup> *Po aty*.

<sup>104</sup> Gjon Boriçi, "Fillimet e marrëdhënieve politiko-ekonomike shqiptaro-kineze 1954-1960", f. 170, separat (në proces botimi); shih edhe *AQSH*, F. 14/OU, V. 1959, D. 18, fl. 13-21, 6 qershor 1959. Tepër sekret: "Vërejtjet e bëra nga shoku N. S. Hrushov gjatë bisedave zyrtare më 25 e 29 maj në Tiranë, si dhe në 3 qershor në Vlorë".

<sup>105</sup> Enver Hoxha, *Hrushovianët*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 356-357.

<sup>106</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1959, D. 18, fl. 10. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës për çfarë i kishte thënë Hrushovi nga ana ushtarake për Shqipërinë: "Nga ana ushtarake ai

edhe përpara Byrosë Politike për ndërtimin e bazës ushtarake të Traktatit të Varshavës në Gjirin e Vlorës. Një marrëveshje ishte nënshkruar në vitin 1957 dhe e dyta në maj të vitit 1959, ndërmjet dy përfaqësuesve ushtarakë [që ishin edhe ministrat e Mbrojtjes së vendeve përkatëse], Beqir Balluku dhe Rodion Malinovski për ndërtimin e kësaj baze, ku në Shqipëri do të instaloheshin përveç katër nëndetëseve të ardhura në vitin 1958, dhe tetë nëndetëse të tjera.<sup>107</sup> Një nga elementet më të rëndësishme që Enver Hoxha nuk e diskutoi në mbledhjen e Byrosë Politike të lartpërmendur, ishte edhe falja e një pjese të kredive të akorduara nga Bashkimi Sovjetik. Kreditë nuk janë falur totalisht, por vetëm pjesërisht dhe jo interesat që arrinin deri në 44% të të gjitha kredive të akorduara.<sup>108</sup>

[Hrushovi] e gjeti vendin tonë si një vend të madh strategjik në Mesdhe. Atij i pëlqeu shumë Vlora. Ai tha se Sazani është më i madh se Kronshtadi. Për liqenin e Butrintit tha që të bëjmë një bazë hidroavionësh, dhe për peshkim, duke u çarë vendi për t'u lidhur me detin. Neve i thamë se këtu jemi shumë afër me grekërit, ata na shikojnë të gjithë. Ai i tha Malinovskit dhe ai e aprovoi këtë gjë dhe porositi që të dërgohen specialistë për të parë këtë gjë. Atij i pëlqeu shumë liqeni nga ana strategjike dhe tha se do ta forcojmë shumë bregdetin tuaj nga ana ushtarake, do të japim raketa etj."

<sup>107</sup> Ana Lalaj, "Shqipëria në Paktin e Varshavës, 1955-1968", në *Studime historike*, nr. 1/2, ASH, Instituti i Historisë, Tiranë: 2004, f. 191-208.

<sup>108</sup> *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1959, D. 40, fl. 3. "Kreditë e akorduara nga Bashkimi Sovjetik për t'u shlyer janë këto:

1. Kredia 2/7/1954, milion 48, shlyerja e së cilës do të jetë vetëm për 10 milion, mbasi pjesa tjetër është përfshirë në faljet që na janë bërë.
2. Kredia 45 milion shlyerja e së cilës do të bëhet vetëm për 4 milion, mbasi 41 milion janë përfshirë në faljet që na janë bërë.
3. Kredia 26/6/1956, milion 55 do të shlyhet vetëm për 53 milion pjesa e përdorur prej 2 milion bën pjesë në faljet.
4. Kredia 17/4/1957 prej 31 milion do të shlyhet totalisht, përdorimi deri më 31 dhjetor 1958 është 25 milion, pjesa e pa përdorur prej 7 milion është parashikuar të përdoret gjatë vitit 1959.
5. Kredia e naftës prej 35 milion përdorimi është parashikuar gjatë vitit 1958, milion 8, në vitin 1959, milion 12 dhe në vitin 1960, milion 15.
6. Kredia 22/XI/1957 prej 160 milion, është përdorur gjatë viteve 1957-1958, milion 63, mbetja prej 97 milion do të përdoret gjatë vitit 1957, milion 47 dhe në vitin 1960, milion 50.
7. Kredia prej 300 milion, përdorimi i saj është parashikuar gjatë viteve 1961-1965, si parashikim për përdorime vjetore është parashikuar: për vitin 1961, milion 70, për vitin 1962, milion 70, për vitin 1963, milion 70, për vitin 1964, milion 70 dhe për vitin e fundit mbetja 20 milion.
8. Kredia speciale prej 38 milion do të shlyhet vetëm për 34 milion, mbasi shuma prej 4 milion që ka qenë përdorur është përfshirë në faljet që na janë bërë. Kreditë e akorduara nga Bashkimi Sovjetik janë me interes vjetor 2%, ka mundësi që të

## Specifika të marrëdhënieve ekonomike të Shqipërisë me Kampin Socialist gjatë vitit 1959

Më 15 janar 1959, nga Moska, zëvendësperfaqësuesi i Shqipërisë në Këshillin Ekonomik të Ndihmës Reciproke-KNER, Vasil Kati, dërgoi një informacion të detajuar mbi veprimtarinë e Komisionit të Tregtisë së Jashtme me vendet e Kampit Socialist.<sup>109</sup> Materiali i paraqitur nga Vasil Kati përfshinte një gamë të gjerë të tregtisë që kishte zhvilluar vendi jo vetëm me vendet e Kampit Socialist, por edhe me vendet kapitaliste në kuadër të KNER-it. Sipas raportit të Katit, për vitin 1958 xhiroja e tregtisë së jashtme të të gjitha vendeve socialiste anëtare të KNER-it ishte 81 miliardë e 600 milionë rubla kundrejt 77.9 miliardë rublave për vitin 1957.<sup>110</sup> Pësja specifike e vendeve socialiste në xhiron e tregtisë së jashtme në KNER ishte për vitin 1958 më shumë se 72%.<sup>111</sup> Për vitin 1959, xhiroja reciproke e vendeve pjesëmarrëse i tejkalonte 52 miliardë rubla sipas marrëveshjeve që ishin nënshkruar.<sup>112</sup>

Marrëveshjet reciproke të mbyllura për vitet 1958-1960 synonin vendosjen e çmimeve në tregtinë e jashtme të vendeve të KNER-it lidhur me përmirësimin dhe unifikimin e normave juridike, që rregullonin marrëdhëniet reciproke në tregti midis vendeve socialiste.<sup>113</sup> Mbledhja e KNER-it në Moskë synonte që të rriste akoma më shumë vëllimin e shkëmbimit të mallrave dhe të krijoheshin kushte akoma më të favorshme për sektorët ekonomikë të demokracive popullore.<sup>114</sup> Për sa u përkte çmimeve të vendosura, ato ishin pranuar që me mbledhjen e Komisionit më 13 dhjetor 1957, e cila kishte vendosur parimin e vendosjes së

---

kërkohej ulja e interesave në masën 0.50%, mbasi kreditë që na janë dhënë nga Republika Popullore e Kinës dhe nga Republika Demokratike Gjermane interesi vjetor është 0.50%. Sikundër shihet nga pasqyra e bashkëngjitur e kredive interesat kapin rreth 44% të kredive të akordura". Tiranë, 28 maj 1959.

<sup>109</sup> *AQSH*, F. 490/KM, V. 1959, D. 1220, fl. 1. Informacion mbi veprimtarinë e Komisionit të Tregtisë së Jashtme. Moskë, 15 janar 1959.

<sup>110</sup> *Po aty*, fl. 94. "Referat për Këshillin Ekonomik të Ndihmës Reciproke mbi punën e bërë nga Komisioni i përhershëm për çështjet e tregtisë së jashtme dhe të dërgimeve komplete për periudhën 1958 dhe mbi drejtimit e mëtejshme të aktivitetit të tij".

<sup>111</sup> *Po aty*.

<sup>112</sup> *Po aty*. Rritja e tregtisë ndërmjet vendeve socialiste krahasuar me vitin 1958 ishte më tepër se 10%.

<sup>113</sup> *Po aty*, fl. 95.

<sup>114</sup> *Po aty*.

çmimeve të tregtisë midis vendeve pjesëmarrëse.<sup>115</sup> Këto parime ishin vendosur nga fakti se çmimet e tregtisë së jashtme duhej t'i përgjigjeshin nivelit të çmimeve botërore, në mënyrë që të forcohej dhe zhvillohej tregtia ndërmjet vendeve socialiste.<sup>116</sup> Konkurrenca ndërmjet dy sistemeve mbizotëruese të Luftës së Ftohtë, ia impononte edhe Kampit Socialist karakterin ekonomik të garës për supremaci ndaj Perëndimit. Për këtë arsye, në vitin 1958 në përputhje me vendimet e Komisionit të marra qysh më 13 dhjetor 1954, ishte bashkërenduar veprimi i organizatave të tregtisë së jashtme të KNER-it për shitjet dhe blerjet e mallrave në tregjet e vendeve kapitaliste.<sup>117</sup> Metoda kryesore e punës tregtare të vendeve socialiste lidhur me veprimet në tregjet e vendeve kapitaliste ishte bashkërendimi me karakterin e mallrave dhe me marrjen parasysht të specifikave të tregut.<sup>118</sup>

Duke hulumtuar me kujdes këtë raport, vërejmë se vendet socialiste e kishin të pamundur të ecnin me hapin e tregtisë së Perëndimit. Mjafton të përmendim faktin e patejkalueshmërisë së burokracisë e cila vononte jo pak avancimin tregtar të vendeve socialiste. Vetëm për vitin 1958 ishin bërë gjithsej 76 mbledhje plus 22 mbledhje të tjera për bashkërendimin e mallrave që kishte përcaktuar Komisioni dhe 54 mbledhje ekstra ishin bërë për të koordinuar iniciativat e organizatave të veçanta të tregtisë së jashtme të vendeve në KNER.<sup>119</sup> Gjithsej, 152 mbledhje dhe harxhim kohe të çmuar për të çuar ekonominë përpara! Siç shpjegohet në raport, mbledhjet e shumta kishin bërë të mundur moskoordinimin nga Komisioni duke sjellë shpenzime të tepërta dhe humbje kohe.<sup>120</sup> Këto dobësi, raporti përpiqej t'i justifikonte me argumentin se vendet kapitaliste vepronin me masa diskriminuese ndaj vendeve të KNER-it.<sup>121</sup> Mallrat e vendeve socialiste nuk ishin cilësore dhe për këtë fakt ishte tërheqja e vendeve të Beneluksit (Holandë, Belgjikë, Luksemburg) nga tregtia me vendet socialiste, gjë që u karakterizua në raport si vendim diskriminues i këtyre vendeve.<sup>122</sup> Si për të justifikuar akoma më tej

<sup>115</sup> *Po aty*, fl. 96.

<sup>116</sup> *Po aty*.

<sup>117</sup> *Po aty*, fl. 98.

<sup>118</sup> *Po aty*, fl. 99.

<sup>119</sup> *Po aty*.

<sup>120</sup> *Po aty*, fl. 101.

<sup>121</sup> *Po aty*.

<sup>122</sup> *Po aty*, fl. 102.

dështimet tregtare me vendet kapitaliste, ishin edhe "krizat financiare" imagjinare që po kalonin këto të fundit në tregtinë e tyre me vendet socialiste.<sup>123</sup>

Delegacioni hungarez i pranishëm në këtë mbledhje kishte propozuar që edhe tregu kapitalist i mallrave dhe tregjeve të merrej në konsideratë njëlloj si tregu socialist.<sup>124</sup> Problem i mprehtë siç e tregoi raporti ishte edhe shqyrtimi si duhet i llogaritjes së shpenzimeve të transportit për Shqipërinë duke pasur parasysh edhe gjendjen specifike gjeografike të saj.<sup>125</sup> Shqipëria ishte vendi më i varfër jo vetëm i Kampit Socialist, por i të gjithë kontinentit europian. Ndhimat dhe kreditë e shumta që kishte marrë nga vendet e Kampit Socialist, investimi i tyre në mënyrë të gabuar në përqindje të madhe vetëm në industrinë e rëndë kishte sjellë pasoja tepër negative për ekonominë e vendit. Një gabim që ishte identifikuar në Mbledhjen e Moskës ishte edhe përdorimi në mënyrë mekanike i çmimeve të tregtisë së jashtme të vendeve të Kampit Socialist.<sup>126</sup> Ky fakt në bën të kuptojmë se çmimin në vendet socialiste nuk e vendoste tregu si në Perëndim, por partia duke sjellë jo pak probleme ekonomike në vendet e Kampit Socialist. Gjithashtu, vendosja e çmimeve stabël për afro një vit, pavarësisht cilësisë së mallrave të vendeve të Kampit Socialist, ishte një tjetër problem që duhej zgjidhur.<sup>127</sup> Për sa u përkiste çmimeve të kontratave në tregtinë e vendeve socialiste me ato kapitaliste sipas Komisionit, mund të përdroreshin si çmime bazë vetëm për mallrat e vendeve socialiste, që i blinin ose i shisnin në tregun botëror kapitalist në sasi mjaft të mëdha.<sup>128</sup> Duke qenë se tregu kapitalist ishte tepër i rëndësishëm për vendet e KNER-it dhe, me sa duket, jo për Shqipërinë,

<sup>123</sup> *Po aty*, fl. 104. Pjesë nga raporti: "Në bazë të vendimeve të sesionit IX të Këshillit Ekonomik në gjysmën e vitit 1958, Komisioni filloi punën për përgatitjet e mbledhjes ekonomike të përfaqësuesve të Ministrive të Tregtisë së Jashtme dhe të Institucioneve shkencore të vendeve pjesëmarrëse në Këshill për shqyrtimin e çështjeve ekonomike sidomos të gjendjes së sotme dhe tregtisë së jashtme në vendet kapitaliste perspektivën e zhvillimit ekonomik dhe të tregtisë së jashtme të vendeve pak të zhvilluara, analizën e zhvillimit perspektiv të tregjeve kryesore, influencën e krizave ekonomike në vendet kapitaliste në tregtinë e tyre me vendet socialiste dhe propozimet për dobësimin e kësaj influence. Mbledhja ekonomike u bë më 5 deri 9 janar të vitit 1959 në Moskë".

<sup>124</sup> *Po aty*, fl. 108.

<sup>125</sup> *Po aty*.

<sup>126</sup> *Po aty*, fl. 110.

<sup>127</sup> *Po aty*, fl. 111.

<sup>128</sup> *Po aty*, fl. 112.

pasi nuk ishte gjëkund konkurrese, në Mbledhjen e Moskës të dhjetorit 1957 u vendos që si bazë për përcaktimin e çmimeve ndërmjet vendeve anëtare, do të merreshin çmimet botërore me vlefshmëri një vit.<sup>129</sup> Zgjedhja e tregut kryesor bazë bëhej nga blerësi, por njëkohësisht duhej të merreshin parasysh dhe interesat e shitësit. Çmimi i kontratës formohej duke i shtuar çmimit bazë edhe shpenzimet e transportit.<sup>130</sup>

Sipas Vasil Katit, RPSH-ja e kishte pranuar parimin e çmimeve botërore dhe në zbatim të tij duhej të ndryshohej parimi i çmimeve stop<sup>131</sup> që vendi kishte me Bashkimin Sovjetik dhe me Rumaninë. Me këto ndryshime sipas përlllogaritjeve, vetëm me tregtinë me Bashkimin Sovjetik për vitin 1958, Shqipëria për mallrat e importit kishte një humbje prej 8 milionë rublash, ndërsa për mallrat e eksportit një fitim prej 3 milionë rublash.<sup>132</sup> Ndërsa me vendet e tjera socialiste sipas Katit, vendi nuk do të kishte ndonjë dëm pasi kishte aplikuar me kohë çmimet botërore.<sup>133</sup> Në mbledhje, Shqipëria kishte shfaqur mosdakordësinë e saj në formimin e çmimeve të kontratave pasi ky fakt i sillte dëm ekonomisë së vendit.<sup>134</sup> Siç vihet re edhe nga raporti i paraqitur në citimin e mësipërm, Shqipëria kishte shumë më tepër leverdi të bënte tregti me vendet e Europës Perëndimore sesa me vendet e Kampit Socialist. Mbi të gjitha, cilësia e tregut përëndimor ishte e pakrahasueshme me atë të

<sup>129</sup> *Po aty*, fl. 128.

<sup>130</sup> *Po aty*.

<sup>131</sup> Shih Gjon Boriçi, "Kredia e fundit kineze për Shqipërinë (1974-1975) – Prelud i prishjes së marrëdhënieve mes dy vendeve", në *Studime historike*, nr. 1-2, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, f. 266.

Çmimi "stop" i përcaktuar nga blerësi në kontratë është më i ulët, ose i barabartë me çmimin aktual të tregut ndërkombëtar.

<sup>132</sup> *AQSH*, F. 490/KM, V. 1959, D. 1220, fl. 129.

<sup>133</sup> *Po aty*.

<sup>134</sup> *Po aty*. Pjesë nga raporti i Vasil Katit: "a. Për eksportin tonë: në rast se blerësi si treg kryesor botëror për hekur nikelin do të zgjedhë Suedinë do të kemi një humbje rreth 5 Rbl për ton, mbasi shpenzimet e transportit nga Suedia në Çekosllovakia janë 30 Rbl për ton, ndërsa nga Shqipëria në Çekosllovakia janë 40 rubla. Si rrjedhim, në bazë të parimit të Protokollit, çmimi i kontratës FOB në portet tona duhet të jetë 5 më pak nga çmimi FOB në portet e Suedisë. Sipas formulimit tonë, çmimi duhet të jetë më i lartë se çmimi FOB në portet e Suedisë dhe kjo për arsye se mund t'ia shesim Italisë që është më afër; b. Për importin tonë: Në rast se si treg botëror kryesor do të zgjedhim Belgjikën çmimi bazë për llamarinën është 600 Rbl toni, por duke qenë se shpenzimet e transportit nga Çekosllovakia në Shqipëri janë më të larta (80 Rbl toni) se nga Suedia në Durrës (40 Rbl toni) çmimi i kontratës CIF në portet tona do të jetë 660 Rbl toni, ndërsa sipas formulimit tonë duhet të jetë 640 Rbl toni".

lindjes, por ishte ideologjia dhe ruajtja e domosdoshme e pushtetit të Enver Hoxhës sesa të ardhurat e tregut ato që komandonin ekonominë shqiptare. Këtë problem, delegacioni shqiptar në KNER e paraqiti me forcë, por nuk iu pranua që të formulohej një klauzolë e veçantë. U pranua vetëm si vërejtje me shënimin e mëposhtëm:

"....delegacionet e vendeve pjesëmarrëse në Këshillin Ekonomik deklaruan se çështja e ndarjes së shpenzimeve të transportit në tregtinë e jashtme me Republikën Popullore të Shqipërisë, duke marrë parasysh konditat gjeografike të veçanta, do të rregullohet në marrëveshje dypalëshe".<sup>135</sup>

Shqipëria e vogël dhe e varfër kishte pranuar në këtë mbledhje (nuk kishte rrugëdalje tjetër për momentin) që gjatë përfundimit të kontratave çmimet duhej të mbylleshin përfundimisht.<sup>136</sup> Vetëm për arsye të jashtëzakonshme dhe me qëllim që të mos pengohej mbyllja dhe realizimi i kontratave, midis palëve kontraktuese mund të bihej dakord për çmime provizore, dhe vetëm në nivelin i cili u përgjigjej afërsisht çmimeve mesatare botërore për mallin në fjalë.<sup>137</sup> Po ashtu, Shqipëria njëlloj si të gjitha vendet e tjera socialiste kishte afat prej tre muajsh për furnizime komplete brenda një periudhe gjashtëmuajore nga data e mbylljes së kontratave, por duhej të binte dakord për çmimin përfundimtar.<sup>138</sup>

(vijon në numrin e ardhshëm / to be continued...)

<sup>135</sup> *Po aty*, fl. 129-130. Shënim nga raporti: "Lidhur me protokollin e Moskës vëmë në dukje se pala bullgare e nënshkroi këtë me vërejtje duke insistuar në ruatjen e principit të çmimeve stop. Në protokollin e këmbimit të mallrave të përfunduara deri më sot me përjashtim të Çekosllovakisë që nuk është përfunduar akoma, klauzola e çmimeve është në forma të përgjithshme (çmimet botërore) pa përcaktuar çështjen e shpenzimeve të transportit, mbasi nuk u pranua formulimi jonë për kompensim të plotë të shpenzimeve të transportit nga tregjet kryesore kapitaliste, deri në portet tona".

<sup>136</sup> *Po aty*, fl. 133.

<sup>137</sup> *Po aty*.

<sup>138</sup> *Po aty*. Përfundimet e raportit: "Në raste të veçanta për vendosjen e çmimit mund të thirren dhe përfaqësuesit e Ministrive të Tregtisë së Jashtme të vendeve përkatëse".

*S u m m a r y*THE SOVIET CREDITS AND LOANS GRANTED TO ALBANIA IN THE  
PERIOD 1945-1960

The period 1945-1960 was very intense for Albania concerning its political and economic relations. The coming into power of the Albanian communists after the liberation of the country at the end of the November 1944, was followed by a rude exercise of power which left the country powerless in both political and economic terms. The above mentioned timeline is brought in this paper through authentic research presenting to the public for the first time the true meaning of the Albanian-Soviet relations mainly being focused in economic terms. This research is divided in two parts because of the huge material found in the Albanian archives recently declassified about the economic relations of Albania with the socialist camp and the Soviet Union in particular. The huge amount of credits granted to Albania from the part of the Soviet Union made possible the economic and consequently the political survival of the Albanian communist regime. The numbers that we are presenting in this paper show beyond any doubt the total vassalage of the Albanian government towards the Soviet Union. The wrong investments of these huge credits and loans for such a small country as Albania in the heavy industry, would made the country totally dependent from the foreign loans and credits where the Soviet Union had primal role. In the first part of this research, are presented with accurate details all the Soviet credits granted to Albania from 1945 until 1958. The total amount of those credits was 742.100.000 rubles. In the second part of this paper which would be published in the next edition of this review, would be presented the problems that Albania was facing at that time from the exercise of coercive economic and political policies from the Soviet Union till the total break of relations between the two countries and how much from these loans Albania has liquidated in favor of the Soviet Union.

